



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT

**THIRRJE PËR APLIKIME**

**PROJEKTET E BASHKËPUNIMIT SHKENCOR DY-PALËSH SHQIPËRI – ITALI**

Në kuadër të Marrëveshjes dhe Programit të Bashkëpunimit mes Ministrisë së Arsimit e Sportit – (MAS) të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit Kombëtar të Kërkimeve – (Consiglio Nazionale di Ricerca- CNR) të Republikës së Italisë, nënshkruar më datë 19.05.2017, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit – AKKSHI, si agjenci ekzekutive, e cilësuar si e tillë edhe bazuar në dokumentin “Programi i Bashkëpunimit në kuadër të marrëveshjes për bashkëpunim shkencor ndërmjet Këshillit Kombëtar të Kërkimit të Italisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë”, fton stafin akademik të institucioneve publike e jo-publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor në Republikën e Shqipërisë të paraqesin projekt-propozimet e tyre.

**KRITERET E APLIKIMIT**

Personat e interesuar, që kërkojnë të aplikojnë, duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm për projektet e bashkëpunimit shkencor dypalësh:

- Formularin e aplikimit që mund të shkarkohet në faqen web të MAS [www.arsimi.gov.al](http://www.arsimi.gov.al);
- Konfirmimin elektronik të bashkëpunimit me stafin akademik partner në Itali;
- Curriculum Vitae;
- Kopjen e titullit apo gradës akademike;
- Kalendarin e aktiviteteve;
- Buxhetin e ndarë në zëra sipas aktiviteteve.

**AKTIVITETET**

Në kuadër të kësaj Marrëveshjeje, aktivitetet e projektit synojnë mobilitetin akademik ndërmjet studiuësve shqiptarë dhe atyre italianë, duke patur për qëllim shkëmbimin e eksperiencave dhe forcimin e bashkëpunimit për projekte afatgjata në kuadër të ERASMUS+, apo HORIZON 2020.

**AFATI**

Projektet e paraqitura duhet të dorëzon pranë Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit – AKKSHI brenda datës 29 shtator 2017 (12:00 ora lokale), në adresën e mëposhtme:  
**Rr. Papa Gjon Pali II; Nr. 3; Godina e Inovacionit**

## **KOHËZGJATJA E PROJEKTIT**

Kohëzgjatja maksimale e projektit është 2-vjeçare.

Gjatë plotësimit të aplikimit dhe kalendarit të aktiviteteve, aplikantët duhet të kenë parasysh se koha e fillimit të projektit është nga 1 Janari 2018.

## **BUXHETI**

Buxheti maksimal për çdo projekt është 2,500 EURO në vit, por aplikantët shqiptarë duhet të paraqesin buxhetin në LEK, sipas kursit zyrtar të këmbimit, në ditën e dorëzimit të aplikimit.

Në bazë të Marrëveshjes dhe Programit të Bashkëpunimit mes MAS dhe CNR, aplikantët duhet të kenë parasysh se buxheti mbulon zëra të mobilitetit akademik si më poshtë:

- “Shpenzime udhëtimi”- përfshihen shpenzimet për dieta, transport dhe fjetje, sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi për dietat.
- “Shpenzime transporti”- përfshihen shpenzimet për karburant, goma, pjesë ndërrimi, riparime, etj.

Në bazë të kësaj Marrëveshjeje, palët kanë rënë dakord se, shpenzimet e udhëtimit (ndërkombëtar apo të brendshëm) dhe të akomodimit për pjesëmarrësit, do të përballohen nga pala dërguese.

Mbështetja e dhënë nga Palët për grupet e kërkimit ka për qëllim të subvencionojë kostot e përgjithshme që lidhen me natyrën ndërkombëtare të projekteve, shpenzimet për udhëtimet ndërkombëtare (kryesisht transportin dhe shpenzimet për dietat ditore). Çdo grup kërkimor mund të aplikojë për mbështetje shtesë nga institucionet e tjera.

Të dyja Palët do të rivlerësojnë shumën e lejuar të pagesave të lidhura me inflacionin dhe në përputhje me kuadrin ligjor të secilit vend.

Vizitori duhet të ketë sigurim shëndetësor, që i jep mundësi të përfitojë trajtim mjekësor falas, për raste urgjencash shëndetësore, në vendin pritës.